V E N D I M
Nr. 516, datë 24.10.2002

PËR ZGJERIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË BASHKISË SË KORÇËS

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, 17 dhe 31 të ligjit nr. 7867, datë 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurive kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zgjerimin e qendrës historike të bashkisë së Korçës në kufijtë e përcaktuar, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të hartojë rregulloren për mbrojtjen e qendrës historike të bashkisë së Korçës.
3. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit që, në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të hartojnë projektin për ruajtjen dhe restaurimin e elementeve përbërës të kësaj qendre.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano